



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:268837
Datë: 22.04.2024
Numri i dokumentit: 05603604

C - IV. – 14 - 3607

Paditësi :

Gj R nga fshati C i Komunës së Rahovecit.

Kundër

E paditura :

Agjencia Kosovare e Privatizimit me seli në Prishtinë, Rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lagjja, "Lakrishtë" Prishtinë.

Për: Palët ndërgjyqëse

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), me gjykatësin e vetëm, Agron Hoxhaj, jashtë seancës dëgjimore, me **dt.22.04.2024**, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

I. HUDHET poshtë si e pa pranueshme padia e paditësit, Gj R nga fshati C i Komunës së Rahovecit.

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Rrethanat Procedurale dhe Faktike :

Paditësi, me dt.12.05.2014 pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovë (DhPGjSK), përmes dërgimit me postë, ka parashtruar kërkesë për ri shikimin e Vendimit të kontestuar, PRZ002 – 0006 të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së (pa datë) për Ndërmarrjen Shoqërore të pa përcaktuar, dhe me llojin e pa përcaktuar të kërkesës e me propozimin që të aprovohet kërkesa e tij dhe të anulohet Vendimi i Autoritetit të Likuidimit, PRZ002 – 0006 dhe e drejta për kompensim të pranohet e më gjerësisht si në këtë kërkesë.

Pala paditëse parashtresën e tij e ka titulluar si “*kërkesë për ri shikimin e Vendimit*”, mirëpo gjykata të njëjtën e konsideron si padi në bazë të nenit 35 par.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, e cila dispozitë bënë trajtimin e barabartë të parashtresave me të cilat bëhet “*nisja e procedurave*” pranë Dhomës së Posaçme, pavarësisht faktit se a quhen padi, kërkesa apo ankesa.

Me dt.11.09.2023, kjo gjykatë, me Urdhrin e saj, C – IV. – 14 – 3607 të dt.11.09.2023, ka urdhëruar paditësin që në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të këtij Urdhri, t’*a plotësoj kërkesën e dt.13.05.2014 për ri shikimin e Vendimit e në përputhje me dispozitat ligjore të nenit 35, 36 par.3 dhe 74 të Ligjit, Nr. 06/L – 086 të dt.30 maj 2019 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK) në atë mënyrë ë kësaj padie (kërkese), t’ia bashkangjes Vendimin e kundërshtuar të Autoritetit të Likuidimit (AL), PRZ 002 – 0067 si dhe provat tjera në mbështetje të kërkesëpadisë së tij, siç janë librezat e punës, apo çdo provë tjetër lidhur me Ndërmarrjen Shoqërore (NSH) në të cilën, ka punuar e në rast se paditësi nuk vepron brenda afatit të dhënë si në pikën I të dispozitivit të këtij Urdhri, në bazë të nenin 36 par.3 të Ligjit, Nr. 06/L – 086 të dt.30 maj 2019 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, padia/kërkesa/ankesa e saj, do të hedhet poshtë si e pa pranueshme ose e njëjta do të refuzohet si e pa bazuar, ose në bazë të nenit 76 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, lidhur me nenin 99 dhe nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPL) të njëjtën padi, gjykata do t’*a hedh poshtë ose të njëjtën padi, do t’ia konsideroj si të tërhequr .**

Paditësja, Urdhrin e kësaj gjykate, C – IV. – 14 – 3607 të dt.11.09.2023, sipas fletëkthesës së kësaj gjykate, e ka pranuar me dt.15.09.2023 por se e njëjti pas kalimit të afatit të dhënë në këtë Urdhër por edhe deri më tani nuk ka vepruar sipas këtij Urdhri të kësaj gjykate për t’*a plotësuar padinë e tij.*

Arsyetimi ligjor:

Padia e paditësit, Gj R nga fshati C i Komunës së Rahovecit, hudhet poshtë si e papranueshme.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1 të Ligjit Nr.06/L - 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK) për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, lidhur me nenin 399 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), gjykata vlerëson se faktet dhe provat që i përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe gjykata merr aktvendim, pa caktuar seancës dëgjimore.

Në bazë të nenit 33 dhe nenin 35 të Ligjit Nr.06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, bëhet fjalë për rregullimin e parashtresave përkatësisht të kërkesave dhe nisjen e procedurave në Dhomën e Posaçme dhe se në nenin 35 par.2 të këtij ligji parashihet se çka duhet të përmbaj një kërkesë/padi, si në rastin konkret.

Po ashtu në nenin 36 paragrafi 2, pika 2.5 dhe 2.6 i Ligjit mbi Dhomën e Posaçme parashihet se: *''Një kërkesë/ankesë është e pranueshme nëse: ... Dhoma e Posaçme ka juridiksion në bazë të nenit 5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme; ... kërkesa/ankesa është parashtruar brenda afatit të përcaktuara në këtë ligj apo ligje të tjera në fuqi kur janë të aplikueshme''*

Në nenin 42 par.2 dhe 3 i Ligjit për Dhomën e Posaçme, parashihet se :*''Pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtruesat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese). Secilës palë tjetër do ti jepet mundësia e arsyeshme për ta kontestuar legjitimitetin apo saktësinë e provave të tilla, nëpërmjet paraqitjes së parashtrësive apo provave tjera (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese) me anë të së cilave synohet përgënjeshtrimi i legjitimitetit apo saktësisë së provave të tilla. Pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë. Nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë''*.

Në nenin 74 Ligjit për Dhomën e Posaçme, që flet për shqyrtimin e vendimeve të Autoritetit për likuidim, aty thuhet se :*'' Procedura para Dhomës së Posaçme për kundërshtimin e vendimit të një Autoriteti të Likuidimit që është duke kryer likuidimin e një ndërmarrje ose aseti sipas Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit do të rregullohet në bazë të këtij neni. Çdo kreditor i Ndërmarrjes i cili ka dorëzuar me kohë kërkesën në Agjenci dhe i cili cenohet nga një vendimi i Autoritetit të Likuidimit mund ta kundërshtojë vendimin e tillë, duke parashtruar një ankesë në Dhomën e Posaçme kundër Agjencisë brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të vendimit. Çdo ankesë e këtillë duhet të bazohet në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në pajtim me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Ankesa duhet të jetë në pajtim me kërkesat e paragrafit 2 të nenit 35 të këtij ligji dhe të bashkëngjisë një kopje të vendimit ndaj të cilit është ngritur kundërshtimi ... ''*.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), palët kanë për detyrë t'i paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla e me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet t'a dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*). Në rastin konkret, paditësit, kjo gjykatë, me Urdhrin e saj, C – IV.– 14 – 3607 të dt.11.09.2023, në kuptim të dispozitave gjegjëse ligjore, ia ka dhënë mundësinë për t'a plotësuar kushtin e pranueshmërisë së kërkesë së tij në atë mënyrë të njëjtin e ka urdhëruar që në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të këtij Urdhri, të plotësojë kërkesën e tij për rishikim e Vendimit e kundërshtuar të AL-së, PRZ002–0006 si dhe kërkesës së tij, t'ia bashkangjes Vendimin gjegjës të AL-së si dhe provat tjera e më gjerësisht si në dispozitivin e këtij Urdhri.

Duke qenë se sipas fletë kthesës së kësaj gjykate, paditësi urdhrin e lartë cekur të kësaj gjykate, e ka pranuar me dt.15.09.2023 por se i njëjti as brenda afatit të caktuar në këtë urdhër por edhe deri më tani nuk ka vepruar sipas tij, pra që nuk e ka sjell Vendimin e kontestuar të AL-së si dhe provat tjera në mbështetje të kërkesëpadisë së tij, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, paditësi, ka dështuar në përmbushjen e kërkesës së dhënë si në Urdhrin e kësaj

gjkate, C - IV. – 14 - 3607 të dt.11.09.2023, andaj edhe për këtë arsye, kjo gjykatë gjeti se padia e paditësit, Gj R nga fshati C i Komunës së Rahovecit, duhet të hudhet poshtë mbi bazën e pa pranueshmërisë së saj.

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 4 par.9, nenit 9, 33, 35, 36, 42, dhe nenit 74 të Ligjit nr.06/L -086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK).

Shpenzimet Gjyqësore

Në bazë të nenin 62 par.5 të Ligjit nr. 06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), gjykata vendosi që secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale në këtë çështje juridike kontestimore.

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS 2022:268837, 22.04.2024

**Gjykatësi,
Agron Hoxhaj**

KËSHILLË JURIDIKE :

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme dhe atë brenda **15 (pesë mbëdhjetë) ditëve** pas ditës së pranimit të këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK).